



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT
TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIËS

Nr. 5490/Prot.

Tiranë, më 01.08.2022

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1706, datë 23.05.2014.

SHOQËRISË “GEGA-G” SH.P.K
Fshati Mirakë, Polis, Mirakë, Librazhd, Elbasan.

Për dijëni: **AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE**
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË
MINIERA

Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Shoqëria “GEGA G” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1706, datë 23.05.2014, për mineralin Gëlqeror i mermerizuar, në Objektin “Dardhë”, Bashkia Librazhd, Qarku Elbasan.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr.3043, datë 13.07.2022, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr.5490, Prot, datë 15.07.2022, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1706, datë 23.05.2014, për mineralin Gëlqeror i mermerizuar, në Objektin “Dardhë”, Bashkia Librazhd, Qarku Elbasan, pasi nuk ka respektuar kërkesat e legjislacionit minerar, ku nga kontrolli në objekt u konstatua se subjekti nuk ka zhvilluar aktivitet minerar që nga momenti i marrjes së lejes minerare.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 1, gërma “f” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit** Nr. 1706, datë 23.05.2014, për mineralin Gëlqeror i mermerizuar, në Objektin “Dardhë”, Bashkia Librazhd, Qarku Elbasan që shoqëria Juaj zotëron.

Referuar pikës 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", keni të drejtë që, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, sipas kushteve të paragrafit të mësipërm, të paraqesë sqarime për shkaqet e përmendura në njoftim për fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare.

Ju bëjmë me dije se, Ministri, do të marrë vendim mbi revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1706, datë 23.05.2014, për mineralin Gëlqeror i mermerizuar, në Objektin "Dardhë", Bashkia Librazhd, Qarku Elbasan, 30 ditë kalendrike pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", të ligjit Nr. 10 304, datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

MINISTRI
BELINDA BALLUKU
ME AUTORIZIM
ZËVENDËSMINISTRI
ILIR BEJTJA

